



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/
PROCUREMENT REVIEW BODY**

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2015

Shkurt 2016

PRISHTINË

PËRMBAJTJA

➤	HYRJE.....	3
➤	FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT.....	4
➤	Baza ligjore në fuqi.....	4
➤	Struktura e OSHP-së.....	6
➤	Organogrami.....	7
➤	Buxheti.....	8
➤	TRAJNIMET.....	9
➤	MARËDHËNIET ME PUBLIKUN.....	11
➤	FAQJA E INTERNETIT.....	12
➤	ARRITJET NË FUSHËN E PROKURIMEVE.....	13
➤	VEPRIMTARIA E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT.....	13
➤	SHQYRTIMI I ANKESAVE TË PROKURIMIT.....	14
➤	URDHËRESAT E SHQIPTUARA NDAJ AUTORITETEVE KONTRAKTUESE	25
➤	GJOBAT, TË HYRAT NGA GJOBAT E SHQIPTUARA DHE DEPOZITAT E ANKESAVE.....	26
➤	PADITË E USHTRUARA NË GJYKATËN THEMELORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NDAJ VENDIMEVE TË PANELEVE SHQYRTUESE.....	26
➤	DISKUALIFIKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK.....	27
➤	REKOMANDIMET E ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	27
➤	OBJEKTIVAT E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2016.....	29

I. HYRJE

Organi Shqyrtues i Prokurimit paraqet para Kuvendit të Republikës së Kosovës, Raportin Vjetor të punës dhe Aktivitetin e tij, për vitin 2015. Organi Shqyrtues i Prokurimit si institucion i pavarur është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 02/L-99, dhe veprimtarinë e vet e ushtron në fushën e prokurimit publik, në fushën e koncesioneve dhe partneritetit publiko-privat. OSHP, ka si objektiv të punës së tij mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të LPP-së, nga ana e Autoriteteve Kontraktuese, gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, e në veçanti mbrojtjen e të drejtave ligjore të operatorëve ekonomikë, kur ata ushtrojnë ankesa kundër vendimeve të AK-së ndaj çdo aktiviteti të prokurimit publik.

Raporti Vjetor i OSHP-së, është një ndër format dhe mënyrat kryesore nëpërmjet të cilit pasqyrohet veprimtaria e këtij institucioni dhe njëkohësisht është një ndër argumentet dhe faktet, se ky institucion e pasqyron dhe e bën publike veprimtarinë e tij, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të operatorëve ekonomik, përkitazi me procedurat e prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandeve publike.

Parimet themelore të institucionit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, janë pavarësia në vendimmarrje dhe evitimi nga çfarëdo lloj ndikimi, transparenca, efikasiteti, efektiviteti, argumentimi dhe arsyetimi i vendimeve të tij. Vendimet e OSHP-së, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga autoritetet kontraktuese gjatë vlerësimit dhe interpretimit të rasteve të ngjashme.

Organi shqyrtues i Prokurimit, me veprimtarinë e tij, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm për rritjen e besimit të palëve nëpërmjet paanshmërisë së vendimeve që merr, si dhe jep garancinë e mbrojtjes ligjore për të gjithë pjesëmarrësit e sistemit të prokurimit publik dhe ankandeve publike.

Kjo praktikë e bazuar në procedurat e shqyrtimit të prokurimit, mendojmë se ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin sa më të drejtë dhe efikas të procedurave të prokurimit nga Autoritetet Kontraktuese, duke synuar parandalimin e çdo veprimi të kundër ligjshëm që cenon interesat e operatorëve ekonomikë dhe mbi të gjitha ruajtjen e fondeve publike, të shpenzimit të tyre me racionalitet.

Këto të arritura janë rezultat i punës së stafit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre, qoftë individual dhe grupor, në kryerjen me përgjegjësi dhe profesionalizëm të plotë të detyrave të punës.

II. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP)

1. Baza ligjore në fuqi

Organi Shqyrtues i Prokurimit ushtron aktivitetin e vet mbështetur në:

- Ligjin nr. 02/L-99 Mbi Prokurimin Publik në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe në amandamentimin e këtij ligji, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/20;
- Ligjin nr. 03/L-241 Për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, 30 Shtator 2010;
- Ligjin nr. 04/L-042 Për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës 31 Gusht 2011;
- Ligjin nr. 04/L-045, të datës: 21 Tetor 2011, Mbi Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënien e tyre;
- Ligjin nr. 02/L-28, të datës: 25 korrik 2005, “Mbi Procedurën Administrative”;
- Legjislacionin dytësor mbi Prokurimin Publik të KRPP-së dhe,
- Rregulloren e Punës së OSHP-së të datës: 22 qershor 2015, nr. 494/2015.

OSHP-ja, është institucion i pavarur, i përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të operatorëve ekonomik vendor apo të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të Autoriteteve Kontraktuese në një procedurë prokurimi apo koncesioni.

OSHP, bazohet në procesin e vendimmarrjes duke u reflektuar në faktin se:

- Anëtarët e OSHP-së, i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër;
- Anëtarët e Bordit janë të pavarur dhe
- Anëtarët e OSHP-së janë të paanshëm, të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm në kryerjen e detyrave të punës.

Mbështetur në legjislacionin e mësipërm, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi:

- Të shqyrtojnë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji;
- Të hetoj dhe përcaktoj faktet që kanë shkaktuar ankesat e tilla;
- T'i japin urdhër çdo personi, ndërmarrje ose autoriteti publik duke kërkuar nga një person, ndërmarrje ose autoritet i tillë që të dorëzojë, bartë, paraqesë dhe/ose mundësojë qasje në të dhëna, informacione, dokumente (përveç këshillave të privileguara juridike), dhe/ose artikuj të tjerë të pasurisë së luajtshme dhe/ose të paluajtshme që paneli shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshem të diskrecionit të vet, i konsideron të rëndësishme për zbatimin e hetimeve ose të procedurave për shqyrtimin e prokurimit.;
- Të nxjerr një urdhër ndaj çdo personi për tu paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe të japë dëshmi lidhur me çdo çështje që Paneli Shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshem të diskrecionit të tij, i konsideron relevante lidhur me lëndën e kësaj procedure;
- Të merr çfarëdo masë tjetër të nevojshme dhe të përshtatshme për të verifikuar argumentet apo pretendimet të bëra nga palët;
- Nëse kontrata përkatëse nuk është nënshkruar ende ligjërisht nga të dy palët, dhe deri më tani të lejuar nga ky ligj, të japin urdhër me të cilën mënjanohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike ose rezultati i një konkursi të projektimit;
- T'i jep urdhër Autoritetit Kontraktues, duke e detyruar Autoritetin e tillë që të suspendojë ose përfundoj zbatimin e aktivitetit të prokurimit ose zbatimin e vendimit të Autoritetit të tillë lidhur me ose gjatë aktivitetit në fjalë;
- T'i jep urdhër Autoritetit Kontraktues, duke e detyruar Autoritetin e tillë që të anuloj ose revokoj vendimin e Autoritetit të tillë lidhur me - ose të marrë gjatë aktivitetit të prokurimit, përfshirë kushtet e paligjshme dhe specifikat në dosjen e tenderit;
- T'i jep urdhër Autoritetit Kontraktues duke e detyruar Autoritetin e tillë që të ia paguaj kompensimin parashtruesit të ankesës;
- T'i jep urdhër Autoritetit Kontraktues duke e detyruar Autoritetin e tillë që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejshëm të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë pale tjetër të interesuar;
- T'i jep urdhër Autoritetit Kontraktues që të mënjanojë specifikimet diskriminuese teknike, ekonomike, financiare, ose të përzgjedhjes, kërkesat ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit ose dokumentet e tjera të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit;
- Të lëshojë një urdhër me të cilin detyrohen zyrtarët për zbatimin e ligjit që ta ndihmojnë OSHP-në, në ekzekutimin e një urdhri të saj;

- Të lëshojë një urdhër i cili e shndërron një kontratë të nënshkruar si të pavlefshme, nëse kontrata është nënshkruar pa publikim të njoftimit sipas nenit 42, ose nëse nënshkrimi i kontratës, është kryer para skadimit të afatit kohor të përcaktuar në nënparagrafin 4.1 paragrafi 4. të nenit 26 i këtij ligji.;
- Të shqiptoj gjoba, nëse Autoriteti Kontraktues, përkundër vendimit të cekur nënparagrafin 2.13. të këtij neni, vazhdon të implementoj kontratën e cila është temë e atij vendimi;
- Refuzimi i Autoriteteve Kontraktuese ose i Autoriteteve Publike për të respektuar vendimin e Paneleve Shqyrtuese ose për të bashkëpunuar me OSHP-në, krijon arsytet që OSHP-ja, të ndërmarrë masa ndaj tyre, në përputhje me nenin 131 të LPP-së.


2 Struktura e OSHP-së

Struktura e Organit Shqyrtues të Prokurimit përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarët e Bordit, si dhe stafi mbështetës i cili udhëhiqet nga kryesuesi i sekretariatit të OSHP-së. Në funksion të organizimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit miratoi Rregulloren e Punës së OSHP-së, të datës: 22 qershor 2015 me nr. të prot. 494/2015, në të cilën përcaktohen qartë detyrat e Kryetarit të OSHP-së dhe të anëtarëve të Paneleve Shqyrtuese, si dhe procedurat e komunikimit ndërmjet tyre. Gjithashtu është paraparë edhe funksionimi i Divizionit të Brendshëm, Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave, si dhe Sektorin ligjor. Po ashtu është miratuar edhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Organit Shqyrtues të Prokurimit e datës: 16 prill 2015, me nr. 334/15.

Me dt: 19 mars 2014, Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur Bordin e OSHP-së, prej pesë anëtarëve me mandat pesë (5) vjeçar.

Për përmbushjen e detyrave të rëndësishme për procedurat e shqyrtimit të ankesave të procedurave të prokurimit publik si dhe për realizimin me sukses të funksioneve për të cilat është themeluar, struktura dhe organogrami i këtij institucioni është konsoliduar duke iu përgjigjur dinamikës së ndryshimeve të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042.

3. ORGANOGRAMI



4. BUXHETI I OSHP-së

Buxheti total për vitin 2015, ka qenë 319,070.00 euro, dhe nga kjo shumë kemi një ndarje sipas kategorive si në vijim:

Sipas Ligjit për Buxhet për vitin 2015, ndarjet kanë qenë si në vijim:

- Paga dhe mëditje kanë qenë te ndara 199,615.00 ndërsa janë alokuar dhe shpenzuar 185,026.12 Euro.
- Mallra dhe Shërbime kanë qenë te ndara 114,355.00 Euro ndërsa janë shpenzuar 105,469.20 Euro
- Shërbime Komunale kane qenë të ndara 5,100.00 ndërsa 1,342.97 Euro janë shpenzuar.
- Për investime kapitale si organizatë buxhetore nuk ka pasur të ndara mjete financiare.

Nga shuma totale e buxhetit për paga dhe mëditje janë shpenzuar mjete në vlerë prej 185,026.12 € që d.m.th në shumën e mjeteve te alokuara, ndërsa shuma e mjeteve tjera nuk është alokuar dhe shpenzuar për shkak se ende nuk ka qenë një pozitë e plotësuar me një anëtar Bordi.

Për mallra dhe shërbime nga buxheti total vjetor për këtë kategori janë alokuar 114,355 €, ndërsa janë shpenzuar 105,469.20 Euro.

Për shpenzime komunale janë alokuar 5,100.00 Euro, ndërsa janë shpenzuar 1,342.97.00 Euro.

Të gjitha të dhënat financiare lidhur me buxhetin e OSHP-së, janë të bashkangjitura në shtojcën financiare të këtij raporti.

III. TRAJNIMET

Organi Shqyrtues i Prokurimit me qëllim të rritjes profesionale të stafit, me synim përballimin në mënyrë sa më efikase të detyrimeve ligjore edhe gjatë vitit 2015, kujdes të veçantë i ka kushtuar trajnimit të anëtarëve dhe personelit të institucionit të OSHP-së.

Duke qenë se trajnimet profesionale janë një proces me karakter vazhdues dhe pasi që me këto trajnime kemi filluar që në vitin e parë të aktivitetit të këtij institucioni, mund të themi se edhe në vitin 2015 i është kushtuar kujdes i veçantë trajnimeve që lidhen me problematika të veçanta të prokurimeve.

TRAJNIMET E NDJEKURA NGA ZYRTARËT E OSHP-së, GJATË VITIT 2015, NË INSTITUTIN E KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE (IKAP)

1. Trajnimi i ndjekur me datën: 15, 16, 17 Shtator 2015, Tema- “Përafrimi i Legjislacionit Vendor me Legjislacionin e Bashkimit Evropian”;
2. Trajnimi i ndjekur me datën: 21- 22 Shtator 2015 me temën– “e-Qeverisja” ;
3. Trajnimi i ndjekur nga Fusha e Prokurimit Publik (BAZIK);

TRAJNIMET JASHTË VENDIT TË ZYRTARËVE TË OSHP-së, GJATË VITIT 2015

- Gjatë muajit Shkurt 2015, përkatësisht me datat: 24-27- Shqipëri, “Hartimin e Raportit të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014”.
- 25-28 mars 2015- Shqipëri, “Hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës”.
- 26-29 mars 2015- trajnim me temën “Partneriteti Publiko-Privat dhe Koncesionet”, të organizuar nga “Economic Development Consulting”.
- 26- 30 prill 2015, vizitë studimore në Skotland- “Vizitën Studimore në Skotland” organizuar dhe financuar nga Projekti “Planet”.

- 10-13 shtator 2015, trajnim me temën: “Rreziqet dhe Kontrolli në Prokurimin Publik – Ekzekutimi i Buxhetit”, të organizuar nga “Economic Development Consulting”.
- 19- 22 tetor 2015 trajnim me temën: “Prokurimi Publik Evropian, edhe Partneriteti Publiko-Privat dhe Koncesionet”, në Dubrovnik – Kroaci të organizuar nga “European Institute of Public Administration (EIPA)”.
- 22- 25 tetor 2015, trajnim me temën: “Menaxhimi financiar dhe kontrolli (MFK) dhe auditimi i brendshëm sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të BE-së”, në Selanik – Greqi, të organizuar nga “Iron Consulting”.
- 22- 24 tetor 2015, trajnim me temën: “Ndryshimet në LPP të Kosovës Nr. 04/L-042, sis dhe krahasimi me Ligjin paraprak”, “Zhvillimi i Platformës së Prokurimit Elektronik në Kosovë”, “Roli dhe rëndësia e prokurimit elektronik”, “Funksionimi i prokurimit elektronik”, “Direktivat e Reja të Prokurimit Publik të BE, të vitit 2014”, të organizuar nga “Balkan Institute For Procurment”.
- 03- 06 dhjetor 2015, trajnim me temën: “Menaxhimi i Personelit– Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – Komunikimi Institucional dhe Teknologjia Informative”, dhe trajnimin: “Prokurimi Publik dhe Menaxhimi i Kontratave”, në Budva – Mal i Zi, të organizuar nga “European Center”.
- 20- 21 dhjetor 2015, takim pune tek: “Vizitën zyrtare tek Komisioni i Prokurimit Publik të Shqipërisë”.

PUNËTORI

1. Gjatë muajit Shtator 2015, përkatësisht me datën: 29-30 Shtator 2015, Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa në OSHP, ka qenë në një punëtori dy-ditore me temën: “Zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Agjencitë e Institucioneve Qendrore”, të organizuar nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) Zyra e Kryeministrit dhe Misioni i OSBE-së, në Kosovë.
2. Gjatë muajit Janar 2015, përkatësisht me datën: 27- 29 Janar 2015, takimi i mbajtur në Bruksel, për temën: “Takimi për Dialogun e Procesit të Stabilizim Asocimit”, të organizuar nga Ministria e Integriteteve Europiane.

III. MARËDHËNIET ME PUBLIKUN

Duke pasur si synim rritjen e transparencës dhe informimin e publikut, një nga prioritetet e veprimtarisë së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015, ka qenë promovimi i aktivitetit të këtij institucioni, i procedurave të shqyrtimit të ankesave, nga njëra anë, dhe rezultateve të arritura në përmbushjen e detyrimeve ligjore, nga ana tjetër.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, i ka kushtuar rëndësi të madhe marrëdhënieve me mediat duke pasur prioritet përmbushjen e objektivave për të rritur besueshmërinë e operatorëve ekonomik dhe të publikut ndaj OSHP-së. Nga ky bashkëpunim kemi forcuar imazhin si dhe pozicionin e Organit Shqyrtues të Prokurimit përball opinionit publik, duke e krijuar integritetin e nevojshëm për realizimin e komunikimit me opinionin publik. Rritja e besimit të operatorëve ekonomik ndaj Organit Shqyrtues të Prokurimit është mbështetur në shqyrtimin e ankesave, mbajtjen e seancave publike dëgjimore dhe në marrjen e vendimeve në mënyrë profesionale, të paanshme dhe brenda afatit të paraparë ligjor. Në disa prej seancave me rëndësi të pjesëmarrjes, kanë qenë prezent ambasadat e huaja në Kosovë, siç është Ambasada e Britanisë në Kosovë, dhe të tjera, mirëpo, përkushtimin tonë për transparencë e dëshmon qartë, dhe më së miri pjesëmarrja e përfaqësuesve të medieve në seancat publike dëgjimore të mbajtura nga panelet shqyrtuese, ç’rast prezent në seancë ka qenë gazetaret e të përditshmëve “Koha Ditore”, “BIRN” etj.

Si vazhdimësi edhe për këtë vit, veprimtaria në drejtim të informimit dhe promovimit të aktivitetit të institucionit, u përqendrua në tre (3) drejtime kryesore:


- a). Informimi i publikut në mediet e shkruara dhe në ato elektronike që lidhen me aspektet e shqyrtimit të ankesave, mendimit të ekspertit shqyrtues dhe ekspertëve shqyrtues- teknik, dhe vendimeve të nxjerrura nga ana e Paneleve Shqyrtuese për ankesat e paraqitura nga Operatorët Ekonomik;
- b). Përmirësimi në mënyrë të ndjeshme mbi dhënien e informacioneve rreth aktiviteteve dhe procedurave të shqyrtimit të aktivitetit të prokurimeve të OSHP-së, në faqen e internetit;
- c). Forcimi i mëtejshëm i traditës tashmë të krijuar të komunikimit me operatorët e ekonomik për paqartësitë dhe nevojat e tyre për t’u informuar dhe njoftuar me zhvillimet ligjore dhe praktikat e mira të prokurimeve publike.

V. FAQJA E INTERNETIT

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me qëllim të rritjes së transparencës përballë të gjitha palëve të involvuara në aktivitete të prokurimit, dhe transparencës karshi qytetarit të Kosovës, ka ridizajnuar ueb-faqen zyrtare “**oshp.rks-gov.net**”, duke filluar me publikimin e pretendimeve ankimore të operatorëve ekonomik, të cilët pretendojnë se ju janë shkelur nga autoritetet kontraktuese. Gjithashtu, OShP, po publikon mendimin e ekspertit shqyrtues dhe vendimin e panelit shqyrtues për çdo lëndë. Poashtu, ueb-faqja përmban versionet elektronike, të të gjitha vendimeve të Paneleve Shqyrtuese, konkluzioneve, urdhëresave, njoftimeve, raporteve dhe informatave tjera të rëndësishme lidhur me aktivitetet e OSHP-së.

Të gjithë këto informata mund të gjenden në adresën tonë zyrtare elektronike „**oshp.rks-gov.net**”, dhe kjo ueb faqe mirëmbahet dhe freskohet çdo ditë dhe njëkohësisht vendosen shkresat në dy gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze. Po ashtu në faqen tonë të internetit gjenden të publikuara njoftime të ndryshme rreth punës dhe veprimtarisë së institucionit tonë, raportet vjetore prej themelimit të institucionit, si dhe të dhënat mbi legjislacionin primar dhe sekondar.

Gjatë vitit 2015, kanë qenë 296.476.00 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë), klikime gjithsej nga 12,199 përdorues të rregullt të ueb faqes. Kurse kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të një vizitori në ueb faqe të OSHP-së, ka qenë 03: 55 min. Në krahasim me vitin e kaluar ka një rritje të interesimit të vizitave në ueb faqen e OSHP-së, prej 14%.



Ueb-faqja e OSHP-së, përveç që është vizituar nga qytetarët e Republikës së Kosovës, po ashtu është vizituar edhe nga vendet e Evropës dhe Amerikës, siç janë: Shqipëria, SHBA, Serbi, Slloveni, Gjermani, Maqedonia, Francë, Mali i Zi, Turqi etj.

VI. ARRITJET NË FUSHËN E PROKURIMEVE

Gjatë vitit 2015, Organi Shqyrtues i Prokurimit, një rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave, si dhe procesit të vendimmarrjes, që të jetë në pajtueshmëri të plotë me Direktivat e BE-së, për Prokurim Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit edhe gjatë vitit 2015, ka pasur bashkëpunim të mirë me Ekipin e Projektit "PLANET"- Përkrahje në Reformimin e Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë. Projekti "PLANET", në çdo kuartal ka hartuar raporte për të tria institucionet e prokurimit publik KRPP, OSHP dhe AQP, duke përcjellur kështu punën e të trija institucioneve dhe përmirësuar në të njëjtën kohë fushën e prokurimit publik në vazhdimësi.

Një bashkëpunim tjetër shumë të rëndësishëm, gjatë vitit 2015, OSHP-ja ka pasur me "SIGMA", Bankën Botërore lidhur me realizimin e prokurimit elektronik.

VII. VEPRIMTARIA E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Shqyrtimi i ankesave të palëve të interesuara (operatorëve ekonomik), që i drejtohen Organit Shqyrtues të Prokurimit, bëhet nga Panelet Shqyrtuese në përbërje prej një (1), tre (3) ose pesë (5) anëtarëve, varësisht prej vlerës së kontratës dhe kompleksitetit të rastit.

Paneli shqyrtues emërohet nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së ankesave të parashtruara, Panelet Shqyrtuese, duke u bazuar në nenet 105.1, 105.2, 106 si dhe 117 të LPP-së, në ekspertizat e ekspertëve shqyrtues dhe në seancat dëgjimore, nxjerrin këto vendime:

- Aprovimin e vendimeve të Autoritetit Kontraktues, kur nuk kanë bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme të prokurimit;
- Rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, nëse Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve, nuk i është përmbajtur kritereve të caktuara në dosjen e tenderit dhe nuk ka bërë vlerësim objektiv;

- Anulimin e aktivitetit të prokurimit, atëherë kur Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje substanciale dhe të pariparueshme të dispozitave të LPP-së, gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit dhe
- Refuzimin e ankesave, atëherë kur ankesat janë të pakompletuara: operatorët ekonomik nuk i janë përmbajtur afateve për parashtrim të ankesës; ose kanë dështuar në ofrimin e deponimit të sigurimit të ankesës.

Funksionimi i punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, përveç se është i paraparë me ligj, të siguroj mbrojtjen e operatorëve ekonomik ankues, gjithashtu garanton që procedurat e prokurimit publik të zhvillohen në harmoni të plotë me parimet bazë të LPP-së, siç janë transparenca, trajtimi i barabartë dhe jo-diskriminues i ofertuesve si dhe shfrytëzimi ekonomik dhe racional i fondeve publike.

VIII. SHQYRTIMI I ANKESAVE TË PROKURIMIT

Organi Shqyrtues i Prokurimit ne vitin 2015, është përpjekur maksimalisht që nëpërmjet procedurave të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimit publik, të realizojë objektivin e tij kryesor që lidhet drejtpërsëdrejti me mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e parregullta të Autoriteteve Kontraktuese në fushën e prokurimit publik.

Gjatë periudhës 5 Janar 2015 – 31 Dhjetor 2015, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar 592 ankesa, për prokurimet publike, për partneritet publiko-privat dhe ankandet, të cilët kanë kundërshtuar vendimet e Autoriteteve Kontraktuese për dhënien e kontratës, vendimet për anulimin e aktiviteteve të prokurimit ose kundër specifikimeve teknike favorizuese apo diskriminuese të parapara në dosje të tenderit.

Duke krahasuar numrin e ankesave të pranuar gjatë vitit 2015, me ato të vitit 2014 vërehet një ngritje rreth 04 % e ankesave për këtë vit.

Paraqitja grafike e ankesave të pranuar në vitin 2014 dhe 2015 (përqindja në rritje)

Lidhur me shqyrtimin e ankesave të Operatorëve Ekonomik, përafërsisht 95% të lëndëve janë mbajtur seanca dëgjimore ku kryesisht kanë marrë pjesë anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e AK-së, si dhe përfaqësuesit e OE-së, dhe pjesëmarrës nga ambasadat e shteteve anëtare të BE-së, shoqërisë civile dhe medie.

Për procedurat e shqyrtimit të ankesave të prokurimit publik gjatë vitit 2015, më poshtë janë të paraqitura të dhënat përmblledhëse dhe analitike të punës si në vijim:

- Paneli shqyrtues, ka aprovuar vendimet e Autoriteteve Kontraktuese, si të bazuara në 166 raste, duke konstatuar se pretendimet e palëve ankimore nuk kanë qenë të mbështetura në argumente ligjore që të aprovohen ankesat e tyre;
- Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për rivlerësimin e ofertave në 196 raste, duke konstatuar se është bërë vlerësimi i gabuar i ofertave nga komisionet vlerësuese, duke hasur në shkeljet e caktuara të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik;
- Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit (Ri-tenderim) në 129 raste, nisur nga shkeljet e konstatuara të dispozitave të LPP-së, për parregullsitë në dosjet e tenderit, vlerësim jo të drejtë të ofertave apo për zhvillimin me mangësi të procedurave të prokurimit;
- Dhjetë (10) ankesa janë hedhur poshtë për shkak të mos-kompletimit të tyre brenda afatit ligjor në pajtim me nenet 111.4 dhe 118.1 të LPP-së;

- Para se të merren në shqyrtim nga Paneli Shqyrtues, 53 ankesa të dorëzuara janë tërhequr nga operatorët ekonomik ankues;
- Gjashtë (6) ankesa të pranuar në OSHP, nuk kanë qenë në kompetencë lëndore të OSHP-së, prandaj janë refuzuar nga OSHP-ja.
- Katër (4) ankesa janë konsideruar si “Res Judicata” (çështje e gjykuar) nga paneli shqyrtues.
- Paneli shqyrtues gjatë vitit 2015, ka lëshuar gjithsej tre (3) urdhëresa.

Si pasojë e mungesës së tre anëtarëve, njëri nga ta, Kryetar i OSHP-së, (pasi që kanë mbetur vetëm dy anëtarë të Bordit të OSHP-së) nga data 15. 01. 2016, 25 ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomik kanë mbetur pa vendim përfundimtar, edhe pse të njëjtat janë shqyrtuar nga ekspertët shqyrtues.

Edhe gjatë vitit 2015, OSHP-ja, ka konstatuar dhe vërtetuar se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit nga ana e autoriteteve kontraktuese nuk janë respektuar dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit sekondar të prokurimit publik. OSHP-ja, në shumicën e rasteve ka hasur në parregullsi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe në marrjen e vendimeve të gabuara për shpalljen e fituesit. Gjithashtu janë konstatuar shkelje të Ligjit mbi Prokurimin Publik, gjë që ka ndikuar që njoftimet për dhënie të kontratës dhe anulim të aktiviteteve të prokurimit, të Autoriteteve Kontraktuese të anulohen dhe lëndët të kthehen në rivlerësim nga ana e Paneleve Shqyrtuese.

Gjatë shqyrtimit të ankesave janë evidentuar shkelje më të shpeshta të këtyre neneve: neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, neni 7 –barazia në trajtim/jo diskriminimi, neni 10- Mjetet për promovimin e Transparencës, neni 27- Dosja e Tenderit, neni 28- Specifikimet teknike, neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës,

Operatorët ekonomikë me rastin e paraqitjeve të ankesave konform nenit 118 të LPP-së, kanë qenë të obliguar të deponojnë sigurimin e ankesave në vlerë nga: pesëqind (500.00) Euro.

Gjatë vitit 2015, OSHP-ja me vendimet që ka marre me rastin e kthimit të lëndëve në rivlerësim (këtu nuk përfshihet numri i 25 ankesave që kanë mbetur pa vendim në mungesë të Kryetarit të OSHP-së) përafërsisht ka kursyer Buxhetin e Kosovës në vlerë prej: 3, 319, 397.54€ (Tre milion e treqind nëntëdhjetë mijë, e treqind e nëntë dhjetë e shtatë euro).

Tabela me të dhënat e Autoriteteve Kontraktuese- Janar - Dhjetor 2015

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ank. të pran uara	Aprov. i vend. AK-se	Ri-vlerësi m	Ri-tender	Tërheqje e anke.	Flakje anke.	Jo kompet. lëndore	Ankesa pa vendim	Urdh. per zbatim te PSH-se	“Res Judikata”
1	MBPZHR	2	2								
2	KK Rahovec	3	1		1	1					
3	KK PRIZREN	16	2	3	6	4			1		
4	QKUK	17	5	4	5			1	1		1
5	KK PRISHTINE	38	12	12	7	1	2	2	2		
6	KK Skenderaj	1		1							
7	UP	11		6	4	1					
8	AUV	5	3	2							
9	KUR Prishtine	7	1	3	3						
10	KRU-Gjilan	1	1								
11	SKGJK	3	1		1	1					
12	MKRS	15	2	5	6	1					1
13	KEK	45	10	21	10	1			2	1	
14	POSTA E KOSOVES	5		3	1	1					
15	K.K FERIZAJ	19	3	5	5	5	1				
16	K.K DECAN	1	1								
17	SHSKUK	2		2							

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ank. të pran uara	Aprov. i vend. AK-se	Ri-vlerësi m	Ri-tender	Tërheqje e anke.	Flakje e anke.	Jo kompet . lëndore	Ankesa pa vendim	Urdh. per zbatim te PSH-se	“Res Judikata”
18	ASK	2	2								
19	KRU-Mitrovica	2	1	1							
20	MF	6		3	2	1					
21	MSH	32	7	17	6	2					
22	KK GJILAN	12	1	1	5	5					
23	KOSTT	5	1	1			1				2
24	MPJ	2	2								
25	S.R Peje	1		1							
26	AQP	22	12	3	7						
27	S.R.GJILAN	2		1	1						
28	Komuna Malisheve	1	1								
29	AMKMK	2		1					1		
30	K. Kamenice	1			1						
31	KK Vushtrri	2	2								
32	MPB	9	2	4	1	1			1		
33	S. R'ISA G.'' Gjakovë	2			2						
34	MAP	12	7	1	3	1					


Nr	Autoriteti Kontraktues	Ank. të pran uara	Aprov. i vend. AK-se	Ri-vlerësim	Ri-tender	Tërheqje e anke.	Flakje e anke.	Jo kompet . lëndore	Ankesa pa vendim	Urdh. per zbatim te PSH-se	“Res Judikata”
35	PTK	19	6	5	3	4				1	
36	KK GJAKOVE	14	1	8	2	1	2				
37	KK DRENAS	1			1						
38	S. P Ferizaj	3		1	2						
39	KRM. PASTRIMI	3	1		1				1		
40	TREPCA	3	1					2			
41	KRU-Prizren	1						1			
42	MFSK	10	5	2	2		1				
43	KK. ISTOG	7	3	1	2					1	
44	AK PRIV.	2		1	1						
45	KK Dragash	1	1								
46	Prokurori I Shtetit	2	2								
47	KUVENDI I RK-se	1			1						
48	KK MITROVICE	1			1						
49	K. K KACANIK	8	1	2	2	2	1				
50	MASHT	5		1		1			3		
51	MTI	2			2						

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ank. të pranuar	Aprov. i vend. AK-se	Ri-vlerësim	Ri-tender	Tërheqje e anke.	Flakje e anke.	Jo kompetente	Ankesa pa vendim	Urdh. per zbatim te PSH-se	“Res Judicata”
52	ATK	1		1							
53	MZHE	8	2	2	2	2					
54	MI	33	17	15		1					
55	KPMM	2	1	1							
56	ASHAK	1	1								
57	Q. E STUDENTEV E	4		3	1						
58	KRU-Bifurkacioni	1		1							
59	KK Kllokot	1		1							
60	DOGANA E KOSOVES	10	3	2	2	1	1		1		
61	ZAP	1				1					
62	MKK	6	1	2	2	1					
63	INFRAKOS	2	2								
64	K.K Graçanice	2	1						1		
65	SHKK	13	2	5	3	2			1		
66	KOM.VITI	7	2	2		1	1		1		
67	K.PODUJEVE	6	2	1	1	1			1		
68	MPMS	1							1		

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ank. të pranuar	Aprov. i vend. AK-se	Rivlerësim	Ritender	Tërheqje e anke.	Flakje e anke.	Jo kompet. lëndore	Ankesa pa vendim	Urdh. për zbatim të PSH-se	“Res Judicata”
69	Hortikultura	2	1		1						
70	KRU-RADONIQ	2				2					
71	K.K Suhareke	6	2	3		1					
72	Univ. ‘Haxhi ZEKA’-PEJE	1	1								
73	UPZ	4		3		1					
74	Trainkos	4		2	1				1		
75	KK Peje	21	3	13	1	2			2		
76	Komuna Leposaviq	4	2		2						
77	Termokos	1	1								
79	S.R.PRIZREN	9	2	1	4	2					
80	CDI	2	2								
81	KK Obiliq	2	1		1						
82	KK Kline	8		6	2						
83	IKSHPK	2		1	1						
84	KK Novobërde	1		1							
85	KK Shtime	2	1			1					
86	KK Fushe Kosove	4	4								

Nr	Autoriteti Kontraktues	Ank. të pranuar	Aprov. i vend. AK-se	Rivlerësim	Ritender	Tërheqje e anke.	Flakje e anke.	Jo kompet. lëndore	Ankesa pa vendim	Urdh. për zbatim të PSH-se	“Res Judikata”
87	Policia e Kosovës	16	4	5	4				3		
88	KK Lipjan	8	2	2	4						
89	K.Mitrovices se Veriut	1	1								
89	Telekomi i Kosovës	4	2	1					1		
Gjithsej			166	196	129	53	10	6	25	3	4
		592	592								


Në formë grafike janë të paraqitura numri dhe përqindja e ankesave të pranuar dhe të shqyrtuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për vitin 2015.




Ndarja e ankesave sipas muajve kalendarik:

Gjatë vitit 2015, numri i ankesave sipas muajve kalendarik, ka pasuar ndryshime në disa muaj. Volumi më i madh i ankesave i përket muajve Tetor dhe Nëntor.

Në formë statistikore, në tabelën e më poshtme janë paraqitur numri i ankesave të pranuar sipas muajve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.



Krahasimi i lëndëve të shqyrtuara për vitin 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015



Klasifikimi i ankesave në bazë të vlerave – 2015



VIII. ANKESAT E PRANUARA PËR AKTIVITETET E PROKURIMIT NË AKTIVITET E PROKURIMIT PËR KOMUNAT ME SHUMICË SËRBE

Një hap tjetër është bërë në komunikim me autoritete kontraktuese nga komunat me shumicë serbe. Nga ecuria e ankesave të parashtruara për periudhën Janar- Dhjetor 2015, del se OSHP ka pranuar gjithsej 6 ankesa për aktivitete të prokurimit në komunat e Veriut, të cilat janë shqyrtuar në OSHP, brenda afateve kohore të parapara me LPP. Paneli shqyrtues ka vendosur që 2 lëndë të kthejë në rivlerësim, 2 lëndë janë kthyer në ritenderim, ndërkaq në 2 lëndë është vërtetuar vendimi i AK-së, si i bazuar. Në bazë të informatave që i posedojmë, komunat e Veriut kanë zbatuar në tërësi vendimet e paneleve shqyrtuese të OSHP-së.

OE- AUTORITETET KONTRAKTUESE	Titulli
AK- KK Lepsaviq	“Ndërtimi i rrugëve ne qytet dhe fshatrave ne Komunën e Lepsaviqit, afërsisht 30 km sipas një liste te aprovuar nga Komuna e Lepsaviqit”
AK-KK Lepsaviq	“Ndërtimi i rrugëve ne qytet dhe fshatrave ne Komunën e Lepsaviqit, afërsisht 30 km sipas një liste te aprovuar nga Komuna e Lepsaviqit”
AK- KK Graçanicë	“Asfaltimi i rrugës neper Graçanice deri tek kopshti i fëmijëve- Ritender ” me nr prok: “618/15/019/521”
AK- KK Lepsaviq	“Ndërtimi i rrugëve ne qytet dhe fshatrave ne komunën e Lepsaviqit” me nr prok : “641 15 001 511”
AK- KK Mitrovica e Veriut	Blerja e kamionëve per grumbullimin e mbeturinave” me nr prok: “647/15/037/111
AK- KK Lepsaviq	Furnizim per 2 mjete te renda te transportit(per zjarrfikje dhe kamion per mbledhje te mbeturinave)Lot I dhe Lot III ” me nr prok: “641/150/111

IX. URDHËRESAT E SHQIPTUARA NDAJ AUTORITETEVE KONTRAKTUESE

Me Ligjin për Prokurim Publik (LPP), përcaktohet qartë se vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit, pas shqyrtimit të ankesave, janë përfundimtare, mirëpo disa Autoritete Kontraktuese i kanë neglizhuar procedurat e prokurimit publik, duke mos i respektuar vendimet e paneleve shqyrtuese për rivlerësimin e ofertave apo anulimin e aktiviteteve të prokurimit. Veprimet e këtilla të Autoriteteve Kontraktuese përbëjnë shkelje të LPP-së, e njëkohësisht kanë edhe efekt negativ në shfrytëzimin racional të fondeve publike.

Për shkak të mos respektimit të vendimeve të Paneleve Shqyrtuese, OSHP-ja, ka shqiptuar gjithsej 7 (shtatë) urdhëresa ndaj Autoriteteve të ndryshme kontraktuese.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të dhënat lidhur me shqiptimin e urdhëresave ndaj Autoriteteve Kontraktuese, për mosrespektim të vendimeve të Paneleve Shqyrtuese.

URDHERESAT E SHQIPTUARA NDAJ AUTORITETEVE KONTRAKTUESE

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Urdhëresa te shqiptuara për mos respektim te vendimit te PSH-se
1	Posta dhe Telekom i Kosovës	2
2	Korporate Energjetike e Kosovës	2
3	Ministria e Infrastrukturës	1
4	Kuvendi Komunal Kline	1
5	Kuvendi Komunal Istog	1
	Gjithsej	7

IX. GJOBAT, TË HYRAT NGA GJOBAT E SHQIPTUARA DHE DEPOZITAT E ANKESAVE

Me datën 01 dhjetor 2015, konform vendimit nr. 58/15, 72/15 dhe 519/14, OSHP, ka ekzekutuar gjobën e shqiptuar ndaj autoritetit kontraktues Posta dhe Telekom i Kosovës sh. a, në vlerë prej 30,000.00 euro. Poashtu, gjatë vitit 2015 OSHP, ka shqiptuar masën e anulimit të certifikatës së profesionalizmit në prokurim për tre (3) zyrtar të prokurimit më autoritetet kontraktuese, Posta dhe Telekom i Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës dhe Ministria e Financave, ndërkaq AK KEK dhe AK- PTK iu është shqiptuar edhe gjoba në vlerë prej 30, 000. 00 eurosh.

Siç dihet, vendimet e OSHP-së, janë vendime përfundimtare dhe të ekzekutueshme, mirëpo në disa raste, Thesari- MF-i nuk i zbaton vendimet tona, në lidhje me gjobat, me arsyetimin se ky institucion i ekzekuton vetëm vendimet e plotfuqishme të gjykatave kompetente, e jo edhe ato të organeve administrative, siç është edhe rasti me OSHP-në. Për këtë arsye, shuma tjetër e gjobave të shqiptuara gjatë viteve 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013 në vlerë prej: 136.000.00 €, nuk është arkëtuar as gjatë vitit 2015, fakt i cili është shqetësues për institucionin tonë.

XI. PADITË DHE VENDIMET E GJYKATAVE- 2015

Sa i përket vendimeve të gjykatave, gjatë vitit 2015, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar këto vendime nga gjykata Themelore, gjykata e Apelit dhe Supreme:

Gjykata themelore në Prishtinë, ka aprovuar kërkesëpadinë e operatorëve ekonomik në një (1) rast, Gjykata Themelore në Prishtinë, ka refuzuar kërkesëpadinë e operatorëve ekonomik në dy (2) raste.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, ka refuzuar ankesat e OSHP-së kundër vendimit të themelores në pesë (5) raste, Gjykata e Apelit në Prishtinë, ka refuzuar ankesat e operatorëve ekonomik, kundër vendimit të themelores në katër (4) raste, Gjykata e Apelit në Prishtinë, ka aprovuar ankesat e operatorëve ekonomik, kundër vendimit të themelores në një (1) rast.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar kërkesën e operatorëve ekonomik për shtyrje të afatit për ekzekutim të vendimit të OSHP-së në një (1) rast, Gjykata e Apelit në Prishtinë ka refuzuar ankesën e operatorëve ekonomik (ankesë kundër vendimit të gjykatës themelore në Prishtinë) për shtyrje të afatit për ekzekutim të vendimit të OSHP-së, në dy (2) raste.

Ankesat e operatorëve ekonomik që kanë shkuar në gjykatën e Apelit gjatë vitit 2015 dhe janë ende në shqyrtim e sipër, janë tri (3) gjithsej, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka bërë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në gjykatën Supreme në dy (2) raste.

XII. DISKUALIFIKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK

Gjatë vitit 2015 OSHP, ka pranuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues- Korporata Energjetike e Kosovës, për diskualifikim të operatorit ekonomik konform nenit 99.2 të LPP-së, dhe OSHP-ja me rastin e kërkesës së autoritetit kontraktues “KEK sh. a” ka marrë vendim që kërkesa e AK-së, të aprovohet, dhe ka diskualifikuar operatorin ekonomik “G-Team” nga Çekia, për shkak të falsifikimit të certifikatës PED 97/ 23 EC moduli H/H1.

XIII. REKOMANDIMET E ZYRËS SË AUDITORIT TE PËRGJITHSHËM

Organi Shqyrtues i Prokurimit është organizatë e pavarur buxhetore dhe nuk i përmbush kërkesat e Ligjit të Auditimit për emërimin e auditorit të brendshëm, pasi ka një buxhet të kufizuar dhe numër të vogël të pozitave të lejuara.

Ne mungesë të auditorit të brendshëm, auditimi i OSHP-së, bëhet nga Njësia e Auditimit e MF-së si dhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura rekomandimet e ZAP-it dhe veprimet e ndërmarra:

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar
1	Hartimi i PVF në përputhje me kornizën ligjore	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për rekomandimin lidhur me disa korrigjime që nuk kanë qenë materiale por me tepër janë konsideruar teknike.
2	Plani i veprimit për hartimin e rekomandimeve	OSHP ka ndërmarr veprimet e nevojshme për përmbushjen e secilit rekomandim dhe në bazë të shkresës së dërguar nga ZAP për vitin 2015 shihet se pjesa më e madhe e rekomandimeve janë përmbushur, dhe pjesa tjetër është mbetur në përfundim të vitit 2015, e që tani konsiderojmë se janë përmbushur.

3	Raportimi tek menaxhmenti	Është përmbushur, plotësisht pasi që çdo zyrtar raporton në mënyre te detajuar tek menaxhmenti.
4	Shpenzimi i buxhetit që përputhet me kodet ekonomike	Janë bere disa gabime tek kodet ekonomike te cilat janë korrigjuar me përfundim te vitit
5	Gabimet ne Prokurim	Edhe rekomandimi nr. 5 është përmbushur pasi që është e pamundur te parashihen 100% të nevojave në planin e prokurimit, ndërsa ligji i lejon mundësinë që të realizohen prokurime jashtë planit por duhet njoftuar AQP-në.
6	Shpenzimet për udhëtime zyrtare te jenë në harmoni me kornizën ligjore	Është marrë për bazë ky rekomandim dhe se çdo shpenzim i referohet rregullave lidhur me shpenzimet zyrtare, edhe këto shpenzime mund te tejkalohe pasi që varen nga organizatori dhe nuk varen drejt për drejt nga OSHP-ja.
7	Rekrutimi i stafit	Që nga rekomandimi i dhënë nuk kemi pasur ndonjë pozitë të lejuar për rekrutim te stafit të ri.
8	Regjistrimi i pasurive sipas kategorive	Te gjitha pasuritë janë të regjistruara në kategoritë përkatëse, pasi që në bazë të të gjeturave ka rezultuar se disa pasuri nuk janë te regjistruara në kategori adekuate.
9	Identifikimi i pasurive me barkode	Ka qenë mungesë e barkodeve për të cilat përgjegjësinë e bartë MAP pasi që ajo ka realizuar kontratën lidhur me e-pasurine, megjithatë ne i kemi vene barkodet të cilat i kemi shtypur vet deri në sjelljen e barkoreve nga MAP-i.
10	Regjistrimi i shpenzimeve për automjete në bazë individuale	Çdo shpenzim mbahet në baza individuale .
11	Mbështetje e AB nga Ministria e Financave	Është përmbushur, pasi që në vitin 2015 jemi audituar nga AB- Ministrisë së Financave dhe gjithashtu kemi bërë kërkesë për vitin 2016 që të përfshihemi ne planin e auditimit.

XIV. OBJEKTIVAT E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2016

Objektivi kryesor i Organi Shqyrtues të Prokurimit është funksionimi më i mirë dhe i pavarur i institucionit në shërbim të operatorëve ekonomik, për mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme nga veprimet apo mosveprimet e Autoriteteve Kontraktuese. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet profesionalizmit, efikasitetit, efektivitetit dhe paanësisë për vendimmarrje të drejtë. Gjithashtu rëndësi tejet të veçantë do ti kushtohet transparencës karshi të gjitha palëve pjesëmarrëse në procedurë.

Synim i punës sonë për vitin që vjen është dhënia e këshillave ligjore për operatorë ekonomik dhe palëve tjera me interes, nëpërmjet rekomandimeve, propozimeve të ndryshme, shqyrtimi dhe nxjerrja e vendimeve të drejta në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-së.

Rritja e cilësisë së shërbimeve dhe transparenca në veprimtarinë tonë ndaj operatorëve ekonomik dhe publikut do të vazhdojë të jetë në objektivat tona, për faktin se tashmë është testuar se kjo veprimtari ka rritur besimin e operatorëve ekonomik ndaj Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe të ushtrimit të ankesave të tyre ndaj AK-së, që dyshohet se kanë bërë shkelje të dispozitave të LPP-së.

Në funksion të këtyre sfidave, që mbeten edhe për të ardhmen, do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë ndër të tjera edhe këtyre objektive:

- Që edhe më shumë të ngritët shkalla e profesionalizmit, me qëllim që të rritet edhe më tutje besimi i operatorëve ekonomik dhe palëve me interes, në veprimtarinë e institucionit tonë;
- Edhe për këtë vit, synim i jonë është ngritja e kapaciteteve dhe profesionalizimit të ekspertëve shqyrtues dhe të stafit mbështetës të administratës, përmes trajnimeve të organizuara nga Institucionet ndërkombëtare dhe vendore në lëmin e prokurimit publik dhe të partneriteteve publiko private, dhe punësimin si staf i rregullt edhe i tre (3) ekspertëve shqyrtues dhe një (1) zyrtari/e ligjor, me qëllim që të profesionalizohet edhe më tej zyra ligjore dhe shqyrtimi i ankesave të operatorëve ekonomik të kryhet në afate rekorde.
- Duke qenë më transparent me operatorët ekonomik dhe të gjitha palët e interesuara, ne do të plotësojmë akoma më shumë ueb-faqen tonë me informata të nevojshme mbi proceset e vendimmarrjes së vendimeve të Paneleve Shqyrtuese, dhe publikimin e të gjitha vendimeve që nga paraqitja e ankesës, mendimit të ekspertit shqyrtues, e deri në vendimin final;

- Synojmë që të kemi bashkëpunim me institucionet homologe relevante në rajon dhe me Organizatat e ndryshme ndërkombëtare që merren me prokurim publik;
- Objektivi i OSHP-së, është që të japë kontribut në realizimin e projektit për fillimin e realizimit të prokurimit publik elektronik, në bashkëpunim me Bankën Botërore;
- Paraqitja e ankesave në mënyrë elektronike – konform plotësim- ndryshimit të ligjit për prokurim publik;
- Viti 2016, do të jetë viti i tetë (8) i funksionimit të plotë të OSHP-së dhe ne mirëpresim kërkesat, sugjerimet dhe vërejtjet eventuale nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të raportuar mbi ecurinë e punës, pasi që ne kemi nevojë për mbështetjen e secilit prej juve për rekomandimet në fushën e prokurimit publik, partneritetit publiko- privat dhe në fushën e koncesioneve, në zbatim të kompetencave ligjore, si një institucion i pavarur, kompetent, i paanshëm në mbrojtje të të drejtave ligjore të çdo operatori ekonomik dhe palëve me interes.

Me respekt për ju, nga:

Tefik Sylejmani

U.D. i Kryetarit të OSHP-ës

Prishtinë

26 Shkurt-2016